

STATUTI I SHOQERISE TREGTARE

AUTO LACI PUKE SH.P.K

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr.9273 date 03.07.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",me date 24.10.2023 u krijuo Shoqeria Tregtare AUTO LACI PUKE SH.P.K,me Ortate te Vetem shtetas Shkelqim Laçi, I datelindjes 08.11.1979,lindur ne Puke, kombesi shqipare,shtetas Hollandez, I identifikuar me numer personal 261661826,e cila do te funksionoje ne baze te ketij STATUTI.

LLOJI DHE EMRI SHOQERISE

NENI 1

Lloji I Shoqerise Tregtare eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar dhe emri I saj eshte AUTO LACI PUKE SH.P.K.

ZYRA QENDRORE DHE TERRITORI

NENI 2

Zyra Qendrore e Shoqerise Tregtare AUTO LACI PUKE SHPK,e ka vendodhjen ne L.14 Shkozet,Zona katastrale 8517 , Godine Banimi 1 KAT,me Numer Pasurie 154/193,Durres.

NENI 3

Veprimtarine e saj Shoqeria Tregtare AUTO LACI PUKE SH.P.K,ka te drejte ta ushtroje ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte saj.

Shoqeria e fiton personalitetin e saj juridik qe nga moment I regjistrimit ne organet perkatese.

OBJEKTIVAT DHE KOHEZGJATJA

NENI 4

Objekt I Shoqerise Tregtare AUTO LACI PUKE SH.P.K eshte :Import dhe Eksport te makinerive dhe makinave te transportit dhe pjeseve te kembimit te reja dhe te perdonura, dhenien e makinave me qira, Sherbime me karrotrec brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise etj.

NENI 5

Shoqeria Tregtare AUTO LACI PUKE SH.P.K., do te kryej veprimtarine dhe aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali Themeltar I regjistruar I Shoqerise Tregtare AUTO LACI PUKE” SH.P.K., perbehet prej 100000 (njeqindemije) leke.

Te gjitha pjeset (kuotat) e Kapitalit Themeltar i perkasin Ortakut te Vetem Themelues te Shoqerise.

Ne funksion te zgjerimit apo t'kurrjes se shoqerise mund te zmadhohet apo zvogelohet kapitali shoqerise.

O rtaku i Vetem i Shoqerise mund te beje kalim te nje pjese te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, me ane te kontrate shitje tek nje person i trete.

Ne rast riorganizimi te dy ose me shume shoqerive, me ane bashkimi, kapitali i themeltar i shoqerise tregtare AUTO LACI PUKE SHPK do te zmadhohet neqoftese kjo e fundit do te jetë shoqeri perthithese.

TRANSFERIMI KAPITALIT

NENI 7

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a- Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b- Shitblerjes
- c- Trashegimise
- d- Dhurimit
- e- Cdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

Asambleja e Pergjithshme e Ortakut te Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakut te Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte perjegjese per marrjen e vendimeve per shoquerine per ceshtjet e meposhteme :

- a- Ndryshimin e statutit
- b- Emerimin e shkarkimin e administratoreve
- c- Emerimin e shkarkimin i likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- d- Percaktimin e shperblimeve per administratoreve,likujdatoreve dhe eksperteve te autorizuar.

dh-Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire pegatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.

- e- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- f- Zmadhimin e zvogelimin e kapitalit.
- g- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- h- Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- i- Riorganizimin e prishjen e shoqerise.
- j- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.
- k- Ceshtjeve te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- l- Nisjen e ndonje hetimi te posacem per ndonje parregullsi te kryer gjate ushtrimit te veprimtarise tregtare,duke caktuar nje ekspert te pavarur.
- m- Te kerkoje prane gjykates shfuqizimin e vendimeve te administratorit kur ato jane ne shkelje te ligjit.
- n- Marrjen e cdo vendimi tjeter te parashikuar ne Ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 9

Vendimet duhet ter regjistrohen ne Rregjistrin e Vendimeve,te dhenat e te cileve nuk mund te fshihen apo ndryshohen.



Duhet te rregjistrohen ne vecanti,por pa u kufizuar ne to,vendimet:

Per miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimatarise.

Per shperndarjen e fitimive vjetore dhe mbulimin e humbjeve.

Per invenstimet dhe ato per riorganizimin dhe prishjen e shoquerise.

Vendimet e parregjistruara ne Rregjistrin e Vendimeve jane absolutisht te pa vlefshme.

NENI 10

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme,si rregull,mlidhet te pakten nje here ne vit.

Asambleja e Pergjithshme duhet te mlidhet sa here eshte e nevojshme per tu mbrojtur interesat e shoquerise dhe:

Nese sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare rezulton apo ekziston rreziku qe aktivet e shoquerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda tre muajve ne vazhdim.

Nese shoqeria do te te shese apo disponoje ne ndonje menyre tjeter aktive,vlera e te cilave eshte me e larte se pese perqind e aktiveve te shoquerise,te rezultuara ne pasqyrat e fundit financiare,te certifikuara.

Nese shoqeria,brenda dy viteve te para te krijimit te saj,kerkon te bleje pasuri nga ndonje ortak pasuri,vlera e te ciles eshte me e larte se pese perqind e aseteve te shoquerise,te rezultuara ne pasqyrat e fundit financiare,te certifikuara.

NENI 11

Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesmarres,per ndryshimin e statutit,per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoquerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres,per ceshtje te tjera si :

a-percaktimi i politikave tregtare te shoquerise

b-emerimin dhe shkarkimin e administratoreve

c-emerimin dhe shkarkimin i likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar

d-percaktimin e shperblimeve

dh-mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret,perfshire
pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
e-perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
f-miratimin e rregullave proceduriale te mbjedhjeve te asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKR per te pasqyruar ndryshimet ne
skeden e shoqerise.

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

NENI 12

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr
vendim per :

- a-vlersimin e veprimtarise se tij
- b-shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c-ngritjen e ndonje padie ndaj tij nga shoqeria
- d-dhenien ose jo te perfitimeve te reja

2.Kur ortaku perfaqeshet nga nje perfaquesues i autorizuar,i autorizuari vlersohet te
jete ne te njejtin konflikt interes,ashtu si dhe ortaku,te cilin perfaqeson.

ADMINISTRIMI

NENI 13

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizik si administrator te
shoqerise.Afat i emerimit eshte 5 vjet,me te drejte riparteritje.Emerimi i
administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKR.

Administrator e nje shoqerie tregtare meme,sipas percaktimit te nenit 207 te ketij
ligji,nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e
anasjelltas.Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

Administrator i Shoqerise Tregtare AUTO LACI PUKE SH.P.K.,emerohet Znj
Sabahete Laçi e identifikuar me ID,Nr.I95518073V me nje afat kohor 5 vjet,me te
drejte riparteritje.



KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

NENI 14

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te :

a)kryej te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise,duke zbatuar politikat tregtare,te vendosura nga asambleja e pergjithshme.

b)perfaqesoje shoqerine tregtare

c)kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise

d)pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor te shoqerise,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe,se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve,i paraqesin keto dokumenta perpara asamblese se pergjithshme per miratim

dh)krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat,qe kercenojne mbarvajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise.

e)kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise,sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit.

f)kryejne detyra te tjera te parashikuara ne ligj dhe statut.

Administratoret jane te detyruar te therrasin asamblene e prgjithshme,ne rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- Shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive,te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Shoqeria brenda 2 viteve te para te regjistrimit te saj,propozon te bleje nga nje ortak pasuri,qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise,qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja emeron me shume se nje administrator ata e administrojne bashkarisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.Padite,qe lidhen me shperblimin e administratorit,ne baze te marrdhenieve kontraktore me shoqerine,rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

NENI 15

Administratori eshte perjegjes individualisht,ndaj shoqerise ose ndaj te treteve,per shkelje te ligjeve,shkelje te statutit,apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marrveshjeve te kryera pa miratim nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise,i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen,per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise,sipas neneve 14.15 ,17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",administratori detyrohet :

1.a)te kryej detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim dhe ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi,duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.

b)te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.


c)te vleresoje me perjegjesi ceshtjet,per te cilat merret vendim.

d)te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit,prezent ose te mundshem,te interesave personale me ata te shoqerise.

dh)te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

2.Administratori,gjate kryerjes se detyrave te tij,pergjigjet para shoqerise per cdo veprim ose mosveprim,qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare,me perjashtim te rasteve kur,ne baze te hetimit dhe vlersimit te informacioneve perkatese,veprimi ose mos veprimi eshte kryer ne mirebesim.

3.Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale,sipas pikave 1 e dy te ketij neni,eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet,qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes,si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta.Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara.



4.Ne menyre te vecante, por pa kufizuar ne to,administratore eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara,nese,ne kundershtim me dispozitat e ligjit”Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”,kryen veprimet e meposhtme :

1. u kthen ortakeve kontributet
2. u paguan ortakeve interesa apo divident
3. u shperndan aktivet shoqerise
4. lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare,kur,ne baze te gjendjes financiare,duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet
5. jep kredi

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku,kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise,perfshire edhe demshperblim finanziar,nese eshte e nevojshme.Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 16


Viti finanziar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.Perjashtimi, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 Dhjetor.

EKSPERTET

NENI 17

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise,ate gjithevetore dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te



ushtruara,te cilat eshte i detyruar t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18

Prishja dhe likujdimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a)kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj
- b)me vendim te Asamblese se Ortakeve
- c)me hapjen e procedurave te falimentimit
- d)nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njofuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit Nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".
- e)me vendim te gjykates

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesen shtese "shoperi ne likujdim e siper".

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve, brenda 30 dite pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

NENI 19

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja.

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjt 9901 date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 20

Baza ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plotë me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.



Per sa nuk parashikohet ne kete statut,do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo ligji specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 21

Mosmarrveshjet.

Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per cfaredo mosmarrveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqipare.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

AUTO LACI PUKE SHPK

Shkelqim Laçi

